



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.235/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Kamenicë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për subjektet politike mbështetësi dhe kandidatët për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2017, mori këtë:

#### VENDIM

**KONSTATOHET** tërheqja e ankesës e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Kamenicë, ZL.A.nr. 235/2017 të datës 17.10.2017.

#### Arsyetim

Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të vendosjes së posterit në banesa kolektive në Kamenicë të kandidatit Qëndron Kastrati për Anëtar të Komunës së Kamenicës nga radhët e subjektit politik LVV, për Zgjedhjet Lokale 2017.

Me datë 19.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë me nr. Protokolli 235/4 për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.235/2017 të datës 17.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës së ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr.235/2017 më datën 20.10.2017.

